



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr.73**

**2004**

**26 tetor**

### **P Ë R M B A J T J A**

Faqe

Ligj nr.9296  
datë 21.10.2004

Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga  
njësitë e qeverisjes vendore ..... 5119

Ligj nr.9297  
datë 21.10.2004

Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003  
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” ..... 5126

Dekret nr. 4364  
datë 21.10.2004

Për dhënie pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë pas ligjit ..... 5127

**LIGJ**  
**Nr.9296, datë 21.10.2004**

**PËR VERIFIKIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E SHTETASVE NGA  
NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin nga njësitë e qeverisjes vendore të shtetasve që banojnë nën juridiksionin e tyre, si dhe, sipas rastit, transferimin e gjendjes së tyre civile.

Neni 2

**Përkufizime**

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Adresë shifrore zgjedhore” quhet kodi shifror i identifikimit, i hartuar sipas nenit 6 të këtij ligji, i cili shërben për identifikimin e vendndodhjes së banesës së shtetasit dhe përdoret vetëm për nevojat e këtij ligji.
2. “Dokument identifikimi” kuptohet letërnjoftimi personal ose një certifikatë lindjeje me fotografi.
3. “Njësi të qeverisjes vendore” quhen bashkitë dhe komunat, ndërsa për qytetin e Tiranës, njësitë bashkiake.
4. “Shtetas me banim të paregjistruar në gjendjen civile të vendbanimit” quhen shtetasit që banojnë në territorin e një njësie të qeverisjes vendore, por që nuk janë të regjistruar në regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile të kësaj njësie.
5. “Zonë regjistrimi” kuptohet territori gjeografik që pasqyron kufijtë dhe madhësinë e zonës së qendrës së votimit.

Neni 3

**Autoriteti zbatues dhe afati i veprimit**

1. Zbatimi i dispozitave të parashikuara nga ky ligj është përgjegjësi e autoriteteve shtetërore të përcaktuara në këtë ligj.
2. Procesi i verifikimit, identifikimit dhe regjistrimit nga njësitë e qeverisjes vendore të shtetasve që banojnë nën juridiksionin e tyre, si dhe, sipas rastit, transferimit të gjendjes civile të tyre, fillon në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përfundon më 28 shkurt 2005.

Neni 4  
**Detyrimi për t'u përgjigjur**

Të gjithë shtetasit janë të detyruar të japin saktësisht të dhënat e kërkuara për procesin e verifikimit, identifikimit dhe transferimit të të dhënave të gjendjes civile.

Neni 5  
**Baza e të dhënave**

Bazë për fillimin e procesit të verifikimit, identifikimit dhe regjistrimit nga njësitë e qeverisjes vendore të shtetasve që banojnë në territorin nën juridiksionin e tyre shërbejnë:

- a) të dhënat e përfshira në regjistrat themeltarë të shtetasve të zyrave të gjendjes civile të njësive të qeverisjes vendore përkatëse;
- b) Baza Elektronike e të Dhënave të Zgjedhësve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për atë që dhe si e parashikon ky ligj;
- c) hartat e njësive të qeverisjes vendore të hartuara nga zyrat e urbanistikës të njësive përkatëse, së bashku me planvendosjen e banesave. Hartat duhet të tregojnë saktësisht kufijtë administrativë të njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

Neni 6  
**Adresa shifrore zgjedhore**

1. Në zbatim të këtij ligji, çdo shtetasi, i cili verifikohet se banon në territorin e një njësie të qeverisjes vendore, i caktohet adresa shifrore zgjedhore përkatëse.

2. Adresa shifrore zgjedhore përbëhet nga tre komponentë:

- a) komponenti i parë është një kod treshifror, i cili pasqyron kodin e zyrës së gjendjes civile që ka nën juridiksion territorin në të cilin banon shtetasi i verifikuar;
- b) komponenti i dytë është një kod katëreshifror që pasqyron numrin e zonave të regjistrimit që përfshihet në territorin nën juridiksionin e zyrës së gjendjes civile, sipas shkronjës "a" të kësaj pike. Sistemi i numërimit të zonave të regjistrimit bëhet sipas sistemit unik kombëtar të numërimit të zonave të qendrave të votimit të miratuar nga KQZ-ja;
- c) komponenti i tretë është një kod treshifror, i cili pasqyron numrin rendor të ndërtesave që ndodhen brenda një zone regjistrimi.

**KREU II**  
**DETYRAT E AUTORITETEVE SHTETËRORE**

Neni 7  
**Kompetenca të posaçme të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit**

1. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit ngarkohet me mbikëqyrjen, bashkërendimin e veprimtarive ndërmjet organeve dhe institucioneve të ngarkuara me këtë ligj dhe verifikimin e zbatimit të tij.

2. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit përcakton metodologjinë dhe nxjerr udhëzimet e nevojshme në bazë e për zbatim të këtij ligji.

3. Jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit harton, miraton dhe u shpërndan njësive të qeverisjes vendore formularët e kërkesave të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

4. Jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit miraton dhe u dërgon kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore sistemin unik kombëtar të adresave shifrore zgjedhore, sipas përcaktimeve të nenit 6 shkronjat "a" dhe "b" të këtij ligji, dhe u kërkon atyre të numërtojnë ndërtesat në territorin nën juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

5. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit zhvillon fushatën e ndërgjegjësimit publik për procesin e verifikimit, identifikimit dhe transferimit të të dhënave të gjendjes civile.

#### Neni 8

##### **Detyra të posaçme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

1. Brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u dërgon kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore të dhënat e mëposhtme, të nxjerra nga Baza Elektronike e të Dhënave të Zgjedhësve pranë tij:

a) listën e shtetasve të regjistruar në zyrën e gjendjes civile përkatëse sipas zonave të regjistrimit, të përcaktuara sipas shkronjës "b" të nenit 6 të këtij ligji. Kjo listë hartohet për çdo zonë regjistrimi;

b) listën e shtetasve që rezultojnë të jenë me banim të paregjistruar në territorin e zonës së regjistrimit, të përcaktuara sipas shkronjës "b" të nenit 6 të këtij ligji, të asaj njësie të qeverisjes vendore, por që janë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile të një njësie tjetër të qeverisjes vendore. Kjo listë hartohet për çdo zonë regjistrimi.

2. Listat, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë emrat e zgjedhësve, të renditur në mënyrë alfabetike sipas mbiemrit, zyrën e gjendjes civile nga e kanë burimin, numrin e regjistrimit dhe atë të faqes së regjistrimit, adresën sipas bazës së të dhënave, numrin e qendrës së votimit, si dhe një kolonë të veçantë për të shënuar numrin e zonës së regjistrimit në territorin e së cilës shtetasi banon në mënyrë të përhershme.

3. Listat, sipas pikës 1 të këtij neni, përgatiten dhe u shpërndahen njësive të qeverisjes vendore nga KQZ-ja.

4. KQZ-ja përgatit dhe shpërndan edhe një formular të plotësuar, i cili do të plotësohet nga grupet e verifikimit gjatë punës në terren me të dhënat e shtetasve që banojnë në mënyrë të përhershme në territorin e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, por që nuk figurojnë në asnjë nga listat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 9

##### **Detyra të posaçme të organeve të qeverisjes vendore**

1. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngre një grup pune që funksionon pranë tij, të përbërë nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, përgjegjësi i zyrës së urbanistikës (për njësitë bashkiake të Tiranës, nëpunësi i ngarkuar me problemet e urbanistikës) dhe nëpunësi që ngarkohet me detyrën e koordinatorit të grupeve të verifikimit. Grupi i punës ka detyrë të organizojë punën përgatitore për verifikimin, identifikimin dhe transferimin e të dhënave të gjendjes civile të shtetasve dhe të kontrollojë zbatimin e detyrave nga strukturat e ndërvuarura.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore duhet të miratojnë ndarjen e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore në zona regjistrimi, t'u caktojnë atyre numrin përkatës sipas sistemit të numërimit unik kombëtar dhe t'i pasqyrojnë ato në hartë. Harta duhet të tregojë në mënyrë të qartë kufijtë e zonave të regjistrimit, numrin rendor të tyre dhe zyrën përkatëse të gjendjes civile që ka nën juridiksion atë zonë regjistrimi.

3. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, zyrat përkatëse të urbanistikës në njësitë e qeverisjes vendore duhet të përfundojnë numërtimin dhe pasqyrimin në hartë të ndërtesave që ndodhen brenda zonës së regjistrimit. Numërtimi fillon rishtas për çdo zonë regjistrimi derisa të numërtohen të gjitha ndërtesat e asaj zone. Për njësitë bashkiake të Tiranës kjo detyrë kryhet nga Zyra e Urbanistikës e Bashkisë së Tiranës.

4. Pas përgatitjes së tyre, hartat bëhen publike në vende me akses të gjerë të publikut pranë zyrave të organeve të qeverisjes vendore, si dhe në zona të tjera publike brenda territorit të qendrave të banuara të përfshira në njësitë përkatëse.

5. Hartat e përgatitura, në çdo rast, nuk shërbejnë si bazë dokumentare ose dokument zyrtar për procesin e legalizimit të zonave informale.

**KREU III**  
**PROCEDURA E VERIFIKIMIT DHE IDENTIFIKIMIT TË SHETETASVE ME BANIM NË**  
**TERRITORIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE**

**Neni 10**  
**Grupet e verifikimit**

1. Për verifikimin e të dhënave në terren dhe dokumentimin e ndryshimeve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore me mbi 5 000 banorë, ngre jo më pak se një grup verifikimi të përbërë nga 2 anëtarë. Një grup verifikimi mbulon jo më pak se 3 zona regjistrimi. Për bashkitë nën 5 000 banorë dhe komunat verifikimi dhe identifikimi, sipas dispozitave të këtij ligji, kryhet nga nëpunësit e administratës përkatëse.

2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, emëron në detyrën e verifikuesit punonjës të administratës së bashkisë ose komunës që, si rregull, gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Si rregull, anëtarët e grupit të verifikimit duhet të kenë përvojë në fushën e zgjedhjeve ose të gjendjes civile.

3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në bashkërendim me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, përcakton brenda afatit të pikës 2 të këtij neni orarin e punës të zyrave të gjendjes civile, ose të grupeve të verifikimit, si dhe përcakton për grupet e verifikimit zonën e mbulimit dhe grafikun e lëvizjes së tyre në terren.

4. Grupi i verifikuesve gjatë procesit të verifikimit përdor tre formularët e përcaktuar në pikat 1 dhe 4 të nenit 8 të këtij ligji.

5. Për zbatimin e këtij ligji nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe anëtarët e grupeve të verifikimit veprojnë nën mbikëqyrjen, autoritetin dhe përgjegjësinë e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

**Neni 11**  
**Verifikimi i shtetasve të regjistruar në gjendjen civile të vendbanimit**

1. Nëse grupi i verifikimit identifikon shtetas me të drejtë vote që gjenden në listën e dërguar nga KQZ-ja, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji, grupi i verifikimit evidenton saktësinë e të dhënave, sipas gjendjes faktike në terren dhe u cakton shtetasve adresën shifrore zgjedhore.

2. Identifikimi i shtetasve bëhet mbi bazën e dokumentit të identifikimit.

3. Në rast se shtetasi nuk disponon një dokument identifikimi, grupi i verifikuesve mban shënim personin dhe banesën përkatëse dhe i cakton një afat të dytë për verifikim mbi bazën e dokumentit të identifikimit. Verifikimi i dytë kryhet jo më vonë se pesë ditë nga verifikimi i parë. Në rast se identifikimi nuk realizohet me verifikimin e dytë, atëherë identifikimi kryhet nga Policia e Rendit në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

**Neni 12**  
**Verifikimi i shtetasve të paregjistruar në gjendjen civile të vendbanimit**

1. Nëse grupi i verifikimit identifikon shtetas që figurojnë në regjistrin e dërguar nga KQZ-ja, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji, grupi i verifikimit evidenton saktësinë e të dhënave, sipas gjendjes faktike në terren dhe u cakton shtetasve adresën shifrore zgjedhore.

2. Identifikimi i shtetasve bëhet mbi bazën e dokumentit të identifikimit.

3. Në rast se shtetasi nuk disponon një dokument identifikimi, grupi i verifikuesve mban shënim personin dhe banesën përkatëse dhe i cakton një afat të dytë për verifikim mbi bazën e dokumentit të identifikimit. Verifikimi i dytë kryhet jo më vonë se 10 ditë nga verifikimi i parë. Në rast se identifikimi nuk realizohet me verifikimin e dytë, atëherë identifikimi kryhet nga Policia e Rendit në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

#### Neni 13

### **Identifikimi i personave pa dokumente identifikimi të gjendjes civile**

1. Nëse grupi i verifikimit identifikon shtetas me banim të paregjistruar në territorin e një zone regjistrimi, që nuk janë në listat e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji, grupi duhet t'u kërkojë këtyre personave një dokument zyrtar identifikimi me burim nga gjendja civile ku të pasqyrohet zyra përkatëse e gjendjes civile dhe numri i regjistrimit dhe fletës së regjistrimit themeltar ku ai është i regjistruar. Grupi i verifikimit shënon në formularin e përcaktuar në pikën 4 të nenit 8 të këtij ligji të dhënat e përcaktuara në formular.

2. Grupi i verifikimit administron dokumentin ose një kopje të tij dhe ia bashkëngjit formularit.

3. Në rast se shtetasi nuk disponon një dokument identifikimi, sipas pikës 1 të këtij neni, por disponon një dokument tjetër identifikimi të ligjshëm, grupi i verifikuesve shënon në regjistër të dhënat sipas atij dokumenti dhe të dhënat e tjera sipas deklaramit të shtetasit, duke specifikuar njësinë e qeverisjes vendore në zyrën e gjendjes civile të së cilës shtetasi është i regjistruar.

4. Grupi i verifikimit i raporton kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të dhënat e personave të verifikuar sipas pikës 1 ose 3 të këtij neni. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose personi i deleguar prej tij, verifikon këto të dhëna në Bazën Elektronike të të Dhënave të Zgjedhësve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke specifikuar njësinë e qeverisjes vendore në zyrën e gjendjes civile të së cilës shtetasi është i regjistruar.

#### Neni 14

### **Identifikimi i shtetasve nga Policia e Rendit**

1. Për personat për të cilët nuk ka qenë i mundur identifikimi i tyre në përputhje me nenet 11, 12 dhe 13 të këtij ligji, brenda 5 ditëve nga konstatimi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore u dërgon organeve të Policisë së Rendit, sipas juridiksionit, listën e personave të paidentifikuar së bashku me të dhënat e grumbulluara për ta, me qëllim identifikimin e tyre.

2. Në zbatim të këtij neni, Policia e Rendit identifikon emrin, atësinë, mbiemrin, zyrën e gjendjes civile ku është i regjistruar personi dhe numrin e regjistrimit themeltar përkatës.

3. Policia e Rendit i dërgon kryetarit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore të dhënat, sipas pikës 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas pikës 1 të këtij neni.

#### KREU IV

### **PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË SHTETASVE ME BANIM NË TERRITORIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE**

#### Neni 15

### **Kërkesa për regjistrim**

1. Procesi i regjistrimit në regjistrin e gjendjes civile, sipas këtij ligji, kryhet në të gjitha rastet kur nga verifikimi janë konstatuar shkaqe ligjore për transferimin e të dhënave të gjendjes civile ose për shkëputje nga trangu familjar.

2. Procedurat e regjistrimit fillojnë me paraqitjen e kërkesës nga kryefamiljari. Grupi i verifikimit i dorëzon kryefamiljarit formularin e kërkesës për transferimin e dokumenteve të gjendjes civile, në përfundim të verifikimit dhe identifikimit të kryer sipas neneve 12, 13 ose 14 të këtij ligji. Formulari nënshkruhet nga kërkuesi në prani të anëtarëve të grupit të verifikimit dhe këta të fundit e konfirmojnë këtë fakt duke nënshkruar kërkesën së bashku me kërkuesin.

3. Në rast se shtetasi i identifikuar sipas neneve 11, 12, 13 ose 14 të këtij ligji nuk banon me kryefamiljarin, atëherë kërkesa përfshin edhe shkëputjen e tij dhe të personave që jetojnë me të nga trangu familjar i kryefamiljarit.

4. Grupi i verifikimit dorëzon në fund të çdo dite formularët e kërkesave për regjistrim,

sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, në zyrën përkatëse të gjendjes civile, të cilat regjistrohen në një regjistër të vaçantë. Me dorëzimin e kërkesave, zyra e gjendjes civile fillon procedurën e transferimit të gjendjes civile të kërkuarit.

5. Regjistrimi i shtetasve sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj nuk ndikon në procesin e legalizimit të banesave të këtyre shtetasve.

6. Në rast të mosnënshkrimit të formularit të kërkesës për transferimin e të dhënave të gjendjes civile, grupi i verifikimit i raporton me shkrim në fund të çdo dite zyrës së gjendjes civile të njësisë vendore përkatëse emrat e personave që nuk pranuan transferimin e të dhënave të gjendjes civile. Këto të dhëna reflektohen nga zyra e gjendjes civile në regjistrin e përkohshëm të shtetasve të peregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit. Lista me emrat e këtyre banorëve i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila bën rregullimin dhe mbikëqyrjen metodologjike të regjistrit të përkohshëm të shtetasve të peregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile.

#### Neni 16

##### **Raportimi vullnetar i të dhënave**

Gjatë periudhës së përcaktuar nga ky ligj shtetasit mund të paraqiten personalisht pranë zyrave të gjendjes civile për të raportuar të dhënat në lidhje me adresën ose vendndodhjen e banesës së tyre brenda një zone regjistrimi dhe, kur është e nevojshme, për të paraqitur ndonjë nga kërkesat e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji. Zyra e gjendjes civile ia kalon për verifikim kërkesat grupit të verifikimit.

#### Neni 17

##### **Procedura për transferimin e gjendjes civile**

1. Të gjitha zyrat e gjendjes civile që i përkasin vendbanimit të ri të shtetasve shqyrtojnë kërkesat e paraqitura për transferimin e fletëfamiljes dhe dërgojnë njoftim zyrtar në zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të vjetër ku ndodhet regjistri themeltar. Për çdo kërkesë njoftimi në zyrën përkatëse dërgohet jo më vonë se 15 ditë nga depozitimi i kërkesës nga grupi i verifikimit në zyrën e gjendjes civile.

2. Zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të vjetër të shtetasve, që kanë marrë njoftimin nga zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të ri për transferimin e fletës së regjistrit themeltar, plotësojnë dokumentacionin e kërkuar dhe e dërgojnë atë në zyrat përkatëse brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së njoftimit.

3. Zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të ri të shtetasve bëjnë regjistrimin përkatës dhe dërgojnë në zyrat përkatëse të vendbanimit të vjetër konfirmimin e marrjes së fletës së regjistrit themeltar të vendbanimit të vjetër të shtetasve brenda 3 ditëve nga marrja e dokumentacionit. Çregjistrimi nga zyra e gjendjes civile të vendbanimit të vjetër bëhet brenda 3 ditëve nga marrja e konfirmimit.

4. Pavarësisht nga neni 21 i këtij ligji, procedurat e transferimit mbyllen në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë nen.

#### Neni 18

##### **Mbulimi i shpenzimeve**

1. Për punën në realizimin e masave të përcaktuara në këtë ligj, punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe anëtarët e grupeve të verifikimit shpërblehen në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shpërblimi sipas pikës 1 të këtij neni dhe shpenzimet e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, të njësisë të qeverisjes vendore dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij ligji përballohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e pikës 2 të këtij neni.

Neni 19  
**Sanksione administrative dhe penale**

1. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile ose anëtarët e grupeve të verifikimit, kur përfshijnë në dokumentacionin që hartohet prej tyre të dhëna të rreme për shtetasit që verifikojnë, përgjigjen penalisht në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

2. Anëtarët e grupeve të verifikimit kur me dashje nuk kryejnë verifikimin dhe identifikimin e plotë në përputhje me nenet 11, 12 dhe 13 të këtij ligji, si dhe kur nuk pranojnë të marrin në dorëzim kërkesat sipas nenit 15 të tij, përgjigjen penalisht në bazë të nenit 248 të Kodit Penal.

3. Shkelja e rregullave të tjera të parashikuara në këtë ligj nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile ose të anëtarëve të grupeve të verifikimit, dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Gjoka vendoset nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore dhe përbën titull ekzekutiv.

4. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore mbajnë përgjegjësi për mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga administrata e ngarkuar me kryerjen e detyrave. Në rast se kryetarët e njësive të qeverisjes vendore nuk përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, ndaj tyre Këshilli i Ministrave nis procedurat e shkarkimit të parashikuara nga ligji nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor".

Neni 20  
**Pezullimi i dispozitave të tjera**

Të gjitha llojet e shërbimeve të gjendjes civile të përcaktuara nga ky ligj, në zbatim të këtij ligji ose të dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë fushë, do të kryhen pa pagesë deri në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 21  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 28 shkurt 2005.

**Shpallur me dekretin nr.4365, datë 25.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr.9297, datë 21.10.2004**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9087, DATË 19.6.2003 “KODI  
ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 dhe 2 shkronja “d”, nenit 83 pika 1 dhe nenit 154 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

## Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 26

#### **Përtëritja e përbërjes dhe zëvendësimi i anëtarëve të KQZ-së**

1. Përbërja e KQZ-së përtërihet çdo tre vjet dhe realizohet në dy faza, sipas modaliteteve dhe procedurave të parashikuara në nenin 22 të këtij Kodi.
2. Në fazën e parë përtërihen 4 anëtarë të KQZ-së:
  - a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
  - b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
  - c) dy anëtarë të zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
3. Në fazën e dytë përtërihen 3 anëtarë të KQZ-së:
  - a) një anëtar i zgjedhur nga Kuvendi;
  - b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
  - c) një anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
4. Anëtarët e rinj të KQZ-së zgjidhen jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen.
5. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së, sipas nenit 25 të këtij Kodi, organi që e ka zgjedhur anëtarin që largohet, emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës. Anëtari zëvendësues qëndron në detyrë deri në mbarimin e afatit të mandatit kushtetues dhe ligjor që gëzonte sipas aktit të zgjedhjes anëtari i larguar para kohe.
6. Pavarësisht nga pika 4 e këtij neni, përbërja e KQZ-së nuk mund të ndryshohet gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në këtë rast, anëtarët ekzistues zëvendësohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës së zgjedhjeve. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga organi përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.”.

## Neni 2

Pas nenit 181, shtohet neni 181/1 me këtë përmbajtje:

### “Neni 181/1

#### **Përfundimi i mandatit të anëtarëve të KQZ-së në funksion të përtëritjes së përbërjes së tij**

1. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 3 të këtij Kodi mbaron më 31 mars 2006. Mandati i anëtarëve të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi, mbaron më 31 mars 2010.
2. Anëtarit të KQZ-së, i cili është zgjedhur fillimisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është përfshirë në përtëritje, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.8609, datë 5.8.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të shfuqizuar, i mbaron mandati në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtari zëvendësues zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përputhje me nenin 22 pika 3 shkronja “a” të këtij Kodi.
3. Mandati i anëtarit të ri të KQZ-së, të zgjedhur në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mbaron në të njëjtën ditë me atë të anëtarëve të tjerë të KQZ-së të parashikuar në nenin 26 pika 2 të këtij Kodi.”.

## Neni 3

Pas nenit 182, shtohet neni 182/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 182/1

**Rishikimi i sistemit të zgjedhjeve**

1. Dispozitat e këtij Kodi Zgjedhor shfuqizohen ditën e nesërme të datës së shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005 për Kuvendin.

2. Brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi vendos për përbërjen, fushën e veprimtarisë dhe procedurat e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar, si dhe për modalitetet e pjesëmarrjes së publikut në procesin legjislativ, lidhur me diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e nismave të nevojshme për rishikimin kushtetues dhe ligjor të sistemit të zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, të zbatueshëm pas procesit të zgjedhjeve të treguar në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4366, datë 25.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**DEKRET**

**Nr. 4364, datë 21.10.2004**

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË PAS LIGJIT**

Në mbështetje të neneve 84, pika 4 dhe 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Miratimin për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                   |
|---------------------------------------------------|
| LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004 |
|---------------------------------------------------|

|     |                                      |      |
|-----|--------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA                           | 600  |
| 2.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE             | 500  |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS PENALE             | 600  |
| 4.  | KODI PENAL                           | 400  |
| 5.  | KODI I PUNËS                         | 500  |
| 6.  | KODI I FAMILJES                      | 450  |
| 7.  | KODI CIVIL                           | 1000 |
| 8.  | KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN | 900  |
| 9.  | KODI ZGJEDHOR                        | 355  |
| 10. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR   | 1500 |

|                           |
|---------------------------|
| PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI |
|---------------------------|

|     |                                                            |      |
|-----|------------------------------------------------------------|------|
| 11. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT       | 800  |
| 12. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK | 1000 |

|                |
|----------------|
| BOTIME TË REJA |
|----------------|

|     |                                               |     |
|-----|-----------------------------------------------|-----|
| 13. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE             | 500 |
| 14. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL | 600 |

DOLI NGA SHTYPI

|                                              |      |
|----------------------------------------------|------|
| PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE | 1500 |
| PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË           | 400  |

Doli nga shtypi më 26.10.2004

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4500 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2004

Çmimi 100 lekë